

20192393727

LIGJ PËR SUBVENCIONIMIN E KONTRIBUTEVE NGA SIGURIMI I DETYRUESHËM SOCIAL PËR SHKAK TË RRIJTJES SË RROGËS

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen lartësia dhe kushtet për subvencionim të kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm social në bazë të rritjes së rrogës (në tekstin e mëtejme: subvencionim i kontributeve).

Neni 2

Qëllimi i këtij ligji është nxitja e punëdhënësve të paguajnë rrogë në shumë më të lartë për shkak të përmirësimit të standardit ekonomik të të punësuarve dhe nxitja e rritjes dhe zhvillimit ekonomike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Neni 3

Shprehje të caktuara të përdorura në këtë ligj e kanë këtë kuptim:

1) "Detyrës për përllogaritje dhe pagesë të kontributeve" është punëdhënësi dhe personi i vetëpunësuar në pajtim me Ligjin për kontribute nga sigurimi i detyrueshëm social (në tekstin e mëtejme: detyrës);

2) "I siguruar" është personi fizik i siguruar detyrimisht sipas ligjeve të cilët e rregullojnë sistemin e sigurimit të detyrueshëm social;

3) "Muaji i parë i subvencionimit" është muaji kur detyrësi për herë të parë ka realizuar subvencionim të kontributeve për të siguruarin e caktuar në pajtim me këtë ligj;

4) "Periodha referente" janë tre muaj të njëpasnjëshëm që i paraprijnë muajit për të cilin detyrësi për herë të parë realizon subvencionim të kontributeve për të siguruar të caktuar në të cilët i siguruari nuk ka mungesë nga puna për shkak të pengesës së përkohshme nga puna, pa marrë parasysh numrin e realizuar të orëve të punës në periudhën referente që i siguruari i ka kaluar në punë të ai detyrës;

5) "Rrogë bazë referente" është rroga neto mujore mesatare, të cilën detyrësi e ka paguar për periudhën referente, të përcaktuar në ditën kur detyrësi për herë të parë realizon subvencionim të kontributeve. Në rrogën bazë referente nuk janë përfshirë kompensimet e paguara të rrogës;

6) "Kontribute nga sigurimi i detyrueshëm social" janë kontributet për sigurim pensional dhe invalidor në bazë të pagesës rrjedhëse, sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital, sigurim shëndetësor, stazh të sigurimit i cili llogaritet me kohëzgjatje të rritur dhe sigurim në rast të papunësisë;

7) "Rritje e rrogës" është dallimi ndërmjet rrogës neto të përllogaritur për muajin për të cilin kërkohet subvencionim i kontributeve dhe rrogës bazë referente të paguar nga detyrësi në periudhën referente dhe

8) "Subvencionim i kontributeve" është pagesa e kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm social nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut në emër dhe për llogari të të siguruarit si detyrës për pagesë të kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm social të llogaritura në dallimin nga rritja e rrogës të përcaktuar në pikën 7) të këtij neni.

Neni 4

(1) Subvencionim të kontributeve mund të shfrytëzojë detyrësi i cili:

- ka status të detyrësit aktiv për llogaritje dhe pagesë të kontributeve, përkatësisht nuk është në procedurë të falimentimit ose likuidimit ose procedurë të shlyerjes në pajtim me Ligjin për shoqëritë tregtare dhe

- nuk ka detyrime të maturuara në bazë të rrogës bruto deri në ditën e kërkesës së subvencionimit të kontributeve.

(2) Subvencionim të kontributeve mund të shfrytëzojë detyrësi për person të siguruar i cili ka qenë në sigurim të detyrueshëm social te ai detyrës në të gjithë muajt nga periudha referente.

(3) Subvencionim të kontributeve mund të shfrytëzojë detyrës për të siguruar për të cilin ka rritje të rrogës si dallim ndërmjet rrogës neto të llogaritur për muajin për të cilin kërkohet subvencionim të kontributeve dhe rrogës bazë referente të paguar nga detyrësi në periudhën referente.

Neni 5

Subvencionim të kontributeve nuk mund të realizojë:

- organ i pushtetit shtetëror dhe lokal dhe organe tjera shtetërore të themeluara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, institucion i cili kryen veprimtari nga sfera e arsimit, shkencës, shëndetësisë, kulturës, punës, mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes së fëmijës, sportit, si dhe në veprimtari tjera me interes publik të përcaktuar me ligj, e të organizuara si agjenci, fonde, institucione publike, ndërmarrje publike dhe shoqëri tregtare të themeluara nga Republika e Maqedonisë së Veriut, komunat, qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit,

- agjenci private për punësim për të siguruar i cili ka kaluar te punëdhënësi nga alineja 1 e këtij neni,

- detyrës i cili për të siguruarin shfrytëzon lirim nga pagesa e kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm social dhe/ose tatimi mbi të ardhurat personale në pajtim me ligjin ose bazë tjetër, për periudhën derisa e shfrytëzon subvencionimin, përkatësisht lirimin,

- detyrës i cili për personin e siguruar shfrytëzon masë për subvencionim të rrogës përmes Planit operativ për programe dhe masa aktive për punësim, për periudhën derisa e shfrytëzon masën dhe

- detyrës i cili për të siguruarin për të cilin kërkon subvencionim të kontributeve i është ndarë mbështetje financiare për punësime të reja në pajtim me Ligjin për mbështetje financiare të investimeve.

Neni 6

(1) Detyrësi nuk është i detyruar të paguajë kontribute nga sigurimi i detyrueshëm social për shumën për të cilën është miratuar subvencionim i kontributeve.

(2) Shuma më e lartë për të cilën miratohet subvencionimi i kontributeve është rritje e rrogës neto deri në 6.000 denarë në muaj për të siguruar.

(3) Shuma më e ulët për të cilën miratohet subvencionimi i kontributeve është rritje e rrogës neto në shumë nga 600 denarë në muaj për të siguruar.

Neni 7

(1) Detyrësi në llogaritjen mujore për arkëtim të integruar, të cilën e parashtron në Drejtorinë e të Ardhurave Publike, për personin e siguruar për të cilin kërkon subvencionim të kontributeve vendos shenjë të publikuar nga Drejtoria e të Ardhurave Publike.

(2) Drejtoria e të Ardhurave Publike për detyrësin i cili kërkon subvencionim të kontributeve për person të siguruar, e kontrollon plotësimin e kushteve nga nenet 4, 5 dhe 6 të këtij ligji.

(3) Nëse janë plotësuar kushtet nga nenet 4, 5 dhe 6 të këtij ligji, Drejtoria e të Ardhurave Publike, e zvogëlon shumën nga detyrimi për kontributet sociale për shumën e subvencionimit të miratuar të kontributeve.

(4) Nëse nuk janë plotësuar kushtet nga nenet 4, 5 dhe 6 të këtij ligji, Drejtoria e të Ardhurave Publike nuk miraton subvencionim të kontributeve dhe e njofton detyrësin për arsyen për të cilën nuk është miratuar subvencionim i kontributeve.

(5) Të dhënat për subvencionimin e miratuar të kontributeve në muajin paraprak në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni, Drejtoria e të Ardhurave Publike i dorëzon në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, më së voni deri në datën 10 të muajit.

(6) Shuma e subvencionimeve të miratuara të kontributeve në muajin paraprak paguhet përmes Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, më së voni deri në datën 25 në muajin rrjedhës.

(7) Mjetet për subvencionim të kontributeve sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(8) Mënyrën e llogaritjes së shumës për subvencionim dhe procedurën e subvencionimit të kontributeve i përcakton ministri i Punës dhe Politikës Sociale në pajtim me ministrin e Financave.

Neni 8

Mbikëqyrje mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji kryejnë Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe Ministria e Financave, secila në lidhje me dispozitat e këtij ligji për çështjet për të cilat ato janë kompetente në pajtim me ligjin.

Neni 9

Dispozita kalimtare dhe përfundimtare

Subvencionimi i kontributeve për rritjen e rrogave në pajtim me këtë ligj, fillon të zbatohet me pagesën e rrogës për muajin tetor 2019.

Neni 10

Akti nënligjor miratimi i të cilit është përcaktuar me këtë ligj, do të miratohet në afat prej 15 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 11

Ky ligj do të zbatohet nga 1 nëntori 2019 deri më 31 tetor 2022.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.